



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 7 Prot.

Tiranë, më 04.01.2023

V E N D I M

Nr.1, datë 04.01.2023

***PËR FILLIMIN E MBIKËQYRJES MBI SITUATËN E MARRËDHËNIEVE TË
PUNËSIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL, TË NËPUNËSVE QË KANË PLOTËSUAR
MOSHËN E PENSIONIT TË PLOTË TË PLEQËRISË***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, si dhe të Metodologjisë “Për përcaktimin e afatit si pjesë e dispozitivit udhërues të vendimit paralajmërues të Komisionerit për rivendosjen e ligjshmërisë”, miratuar me Vendimin Nr.951, datë 29.12.2020, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, për rastet e nëpunësve që plotësojnë kërkesat e nenit 65, germa “c”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dispozitë e cila urdhëron përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për ata nëpunës të cilët kanë plotësuar moshën për pensionin e plotë të pleqërisë,

V E N D O S A:

1. Fillimin e mbikëqyrjes në lidhje me punonjësit që plotësojnë moshën e pensionit të plotë të pleqërisë deri në fund të vitit kalendarik (datë 31.12.2023).
2. Ngritjen e grupit të punës që do të mbikëqyrë këtë proces, me përbërje si më poshtë:

i. **Arbana Basha**
ii. **Irma Vani**
iii. **Antea Kabali**

Drejtor i Përgjithshëm i Inspektimit dhe Mbikëqyrjes
Drejtor i Çështjeve Juridike
Specialist, Drejtorja e Çështjeve Juridike

3. Për realizimin e kësaj detyre, Grupi i Punës të kërkojë nga të gjitha institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore, informacion të detajuar në lidhje me nëpunësit civil të cilët kanë plotësuar kushtet për pensionin e plotë të pleqërisë, si dhe të mbajë komunikim të vazhdueshëm me to me qëllim mbarëvajtjen e këtij procesi.
4. Për dërgimin e informacionit nga institucionet e mësipërme të lihet një afat **30-ditor** nga momenti i marrjes dijeni.
5. Në rast të mosmarrjes në kohë të masave nga ana e njërive përgjegjëse të institucioneve për zbatimin e detyrimit të parashikuar nga neni 65, germa “c”, e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të vijohet me nxjerrjen e vendimeve paralajmëruese, duke lënë edhe një afat prej **30 ditësh** për zbatimin e tyre.
6. Grupi i Punës të ndjekë njëkohësisht zbatimin e vendimeve paralajmëruese të Komisionerit që do të dalin përgjatë këtij procesi.
7. Ky proces do të përmbyllet me një raport vlerësimi të hartuar nga Grupi i Punës, ku do të evidentohet situata për çdo institucion.
8. Ngarkohen me zbatimin e këtij vendimi anëtarët e grupit të punës të përcaktuar në pikën 2. të këtij vendimi, si dhe Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.
9. Ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse që nëpërmjet specialistit të arkiv-protokollit, t’ia njoftojë këtë vendim të gjithë anëtarëve të grupit të punës dhe të ofrojë asistencën e nevojshme logjistike për të mundësuar realizimin e këtij procesi.
10. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha